



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DELVINË
KRYETARI

Nr. 752 Prot.

Delvinë, më 07. 04. 2025

**PËR PËRDORIMIN E MATERIALEVE PROPAGANDISTIKE E EDUKUESE DHE
RREGULLAT PËR AFISHIMIN E TYRE GJATË FUSHATËS ZGJEDHORE**

VENDIM

Në zbatim të Ligjit Nr 139/2015 ,“ Për Qeverisjen Vendore” ,i ndryshuar ,në zbatim të ligjit nr. 10019 ,datë 29.12.2008 ,“Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” të nenit 79 ,pika 1, “Materialet propagandistike”, i ndryshuar, si dhe Udhëzimit nr. 6 ,datë 23.03.2021 ,të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për përdorimin e materialeve propagandistike e edukues dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore”, Kryetari Bashkisë Delvinë vendos vendet e lejuara dhe të ndaluara si më poshtë:

VENDOSI:

1. Materialet propagandistike/edukuese për Fushat Zgjedhore do të lejohen në ambjentet (zyrat) që do të hapi çdo forcë politike duke përfshirë dhe kandidatët e tyre si dhe në rrugën "Veli Kallapodhi" zona murale sapo kalon karburant "Alpet" Delvinë.
- 2.Ndalohet afishimi i materialeve propagandistike në: fasadat e godinave të banimit, institucioneve publike apo ambienteve rrethuese pranë e rreth tyre, brenda zonave rekreative, parqeve, në pemet e qytetit dhe në shtyllat e ndriçimit.
3. Ndalohet vendosja e materialeve propagandistike në mjete që operojne në transportin publik.
4. Vendet e caktuara në piken 1, duhet të jenë në mjedise që sigurojnë shikueshmeri publike dhe të kenë hapësirë të mjaftueshme që të gjitha subjektet zgjedhore që marrin pjesë në zgjedhje të mund të paraqesin materialet propagandistike, programet e tyre zgjedhore dhe/ose mesazhet zgjedhore.
- 5.Lista e materialeve të printuara dhe sendeve të lejuara për fushatë zgjedhore me vlerë më të vogël se 500 lekë.

I. MATERIALE TË PRINTUARA

1. Poster imazhi, logo përkatesie politike dhe mesazhi partia/kandidati.
2. Postera informues/edukues për programin e partisë,letër me lustër me ngjyra.
3. Fletushka për shpërndarje e mesazheve dhe premtimeve elektorale që përcjell partia /kandidati.
4. Fletpalosje për mesazhin dhe premtimet elektorale që përcjell partia/kandidati.
5. Kartolina mesazhi/informacioni për partinë/kandidatin.
6. Kartëvizita zgjedhore për përhapjen e shpejtë të mesazhit elektorial ose kujtesë.

7. Zarfë të personalizuar që përmbajnë letër me mesazhe/programe që percjell partia/kandidati.
8. Broshura të ndryshme me programe të partisë/kandidatit.
9. Dosje të stampuara me logon e partisë/emertimin e partisë/emrin e kandidatit.
10. Simbole ngjitëse stickers me logo.

II. SENDE MATERIALE TË LEJUARA PËR FUSHATË

1. Kapele të stampuar, me logo të partisë, slogan të partisë/kandidatit.
2. Bluza T-shirt stampuar, me logon dhe slogan të partisë/kandidatit.
3. Stilolapsa me logo të partisë ose sllogan.
4. Blloqe agjende me logo/sllogan të printuar.
5. Çanta të stampuara me logo dhe sloganin.
6. Maska me logon e partisë/ose imazhin e kandidatit.
7. Byzylykë me logon e partisë/ emrin e kandidatit.
8. Flamuj me dimensione të vogla me emrin dhe logon e partisë.
9. Afishe ngjitëse version rrethor/katror me permasa të ndryshme.
10. Etiketa të stampuara me logo apo slogan të partisë/kandidatit.
11. Rripa për Badges/etiketash.
12. Tullumbace të stampuara me logon/mesazhin e partisë/kandidatit.
13. Çadra të stampuara me logo.
14. Spila/Kapëse/karficë/bagdes me simbole.
15. Stema/ butona të stampuara me logo.
16. Magnet me logo.
17. Mbajtëse çelësash me logo.
18. Zhurmuese, vuvuzela etj.
19. Covera/adezive të ndryshme në dimensione të vogla.
20. Mbulesa tavoline të stampuara me logo ose mesazhe.

Duke ju falenderuar,

KRYETAR I BASHKISË
Besmir Veli

